



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit direkt të Primo Communications Sh.p.k nga Ad-Trade Sh.p.k

Në datën 11 tetor 2013, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Kontratë Shitblerje Kuotash”, të nënshkruar ndërmjet palëve (“Ad-Trade Sh.p.k” në cilësinë e **blerësit** dhe “Telekom Slovenije d.d” në cilësinë e **shitësit**, me objekt transferimin e 100% te aksioneve të “Primo Communication Sh.p.k” në cilësinë e shoqërisë **target** më datë 3 tetor 2013, me pasojë përfitim e kontrollit direkt nga shoqëria AD-Trade Sh.p.k të shoqërisë Primo Communications Sh.p.k nëpërmjet përfitimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- **AD-Trade Sh.p.k:** ushtron veprimtarinë kryesisht në fushën e tregtisë së materialeve hidraulike, etj;
- **Primo Communications Sh.p.k:** është një shoqëri që ofron shërbime interneti si, shërbime të postës elektronike, internet dhe shërbime telefonike nëpërmjet internetit etj;
- **Telekom Slovenije d.d:** është një shoqëri slllovene e cila operon në fushën e internetit dhe telekomunikacionit në Slloveni e në rajonin e Europës jug-lindore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al